



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 44
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204
Prishtinë, më 16 dhjetor 2016, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fadil Beka, Mirjeta Kalludra, Besa Baftiu dhe Ali Berisha.

Munguan: Fikrim Damka, Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi, ZPRK; Shefki Kastrati, NDI; Berat Thaçi, GAP; Dren Pozhegu, GAP; Fjolla UKA, KDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.11.2016;
3. Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2017:
Ministrinë e Shëndetësisë;
Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.11.2016

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 16.11.2016.

3. Shqyrtimi i projekt buxhetit për vitin 2017:

Ministrinë e Shëndetësisë;

Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Flora Brovina (kryetare) –Sot do të diskutojmë rreth projektbuxhetit për vitin 2017, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Pra, para jush kemi projektbuxhetin për këto institucione. Po ashtu, kemi edhe dy analiza sa i përket projektbuxhetit, të përgatitura nga NDI dhe GAP, të cilat shfrytëzojnë rastin që t'i falënderoj për mbështetjen që na kanë ofruar, me analizat e tyre, që ne si deputetë të kemi një pasqyrë sa më të qartë në raport me projektbuxhetin. Gjatë monitorimit të Ligjit të shëndetësisë dhe monitorimit të punës së MPMS-së, kemi vërejtur se ka nevojë për buxhet shtesë për përmbushjen e objektivave apo planeve të këtyre ministrive. Kurse, sa i përket nevojave të spitaleve, ne të gjithë e kemi parë se ka nevojë, si për hapësira, pajisje dhe staf mjekësor, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira shëndetësore ndaj pacientëve. Po ashtu, gjatë vizitave të shërbimeve shëndetësore, në kuadër të burgjeve dhe qendrave të paraburgimit, që kemi vizituar, kemi vërejtur se kanë nevoja të shumta për krijim të hapësirave adekuate, pajisje mjekësore, pajisje me autoambulancë, si dhe punësimi e stafit të nevojshëm. Urdhëroni, kush dëshironi të diskutoni lidhur me projektbuxhetin? Urdhëroni z. Berisha!

Ali Berisha– Faleminderit kryetare! Të nderuar kolegë deputetë! Ne kemi shqyrtuar këtë projektbuxhet, sa i përket shëndetësisë, edhe pse Qeveria e proklamoi si prioritet, kjo nuk reflekton edhe me buxhet. Sa i përket mjekësisë primare, pothuajse nuk i jepet fare rëndësi, edhe pse është sektor mjaft i rëndësishëm, që ndikon shumë, sidomos bën preventivë të sëmundjeve, sektor që ka direkt qasje me qytetarët dhe sektor që ballafaqohet me kontrollet sistematike të popullatës, gjë që s'po ndodhe tek ne. Pra, një ndarje e tillë e buxhetit, minimale për shërbimet primare shëndetësore dhe lënia e këtij shërbimi komplet në përgjegjësi të komunave, besoj se nuk duhet të ndodhë. Ne e dimë se disa komuna i kemi shumë të varfra dhe shërbimi primar shëndetësor është në kushte jashtëzakonisht të vështira. Në bazë të këtij projektbuxheti, edhe te Ministria e Shëndetësisë, në disa sektorë, nuk ka lëvizje pothuajse fare, si tek Inspektorati Shëndetësor, si institucion mjaft i rëndësishëm për mbikëqyrjen e institucioneve shëndetësore apo kontrollin e tyre, sesi funksionojnë. Pra, s'kemi as rritje të stafit, as buxhet shtesë në përmirësimin e kushteve dhe funksionimit më të mirë të këtij institucioni. Investimet kapitale në shëndetësi, kemi një disproporcion të ndarjes nuk kemi kritere të caktuara si është bërë ndarje e investimeve kapitale për institucionet e caktuara shëndetësore. Pra, ne gjatë monitorimit apo vizitave nëpër institucionet shëndetësore, kemi vërejtur se në disa institucione kushtet e funksionimit janë shumë të vështira. Në disa institucione, kemi mungesë të stafit, ku kushtet janë shumë të mira. Në këtë rast, Qeveria është dashur të bëjë zgjidhje për këto institucione, siç është rasti i spitalit në Vushtrri dhe Mitrovicë. Pra, kemi mungesë të stafit dhe me buxhet nuk parashihet rritje të numrit të stafit për to. Kurse, në spitalin e Gjakovës, edhe pse ka staf, kushtet e funksionimit i ka jashtëzakonisht të vështira dhe nuk është menduar asnjëherë për investimet kapitale në këtë spital, në përmirësimin e kushteve të punës. Buxheti për trajtimin e pacientëve jashtë vendit, duhet të rritet, pasi që kërkesat e qytetarëve për trajtim jashtë vendit, janë në rritje, në mungesë të shërbimeve brenda institucioneve tona. Për këtë shërbim, kemi deficit të buxhetit afro 3 milionë euro, veç për vitin 2016. Po ashtu, edhe te MPMS, te buxheti për mirëqenien sociale vërehet se ligjet të cilat miratohen në Kuvend, nuk janë të mbështetura edhe me buxhet, pra nuk zbatohen. Këtu shihet te kategoria e veteranëve të luftës, familjeve të dëshmorëve dhe

invalidëve të luftës. Qeveria është dashur të ketë parasysh këtë kategori, pasi që ka status të veçantë dhe duhet të trajtohet si e tillë. Ju faleminderit!

Besa Baftiu–Faleminderit kryetare! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Po ashtu, edhe unë shfrytëzoj rastin që t’i falënderoj për mbështetjen që na kanë ofruar me analizat e tyre NDI dhe GAP, që ne si deputetë të kemi një pasqyrë sa më të qartë, në raport me projektbuxhetin. Buxheti për shëndetësi, edhe pse ka një rritje simbolike, prapëseprapë nuk është një buxhet që i mbulon nevojat reale për pacientët. Qeveria, si prioritet të pestë e ka renditur shëndetësinë, mirëpo duke parë buxhetin se sa është ndarë për shëndetësi, nuk reflekton si prioritet dhe nuk shohim një dallim me vitet e mëhershme. Buxheti i SHSKUK për barna, është ndarë një buxhet tejet i vogël, diku 70 milionë. Me këtë buxhet, nuk mbulohet lista esenciale e barnave, pra duhen diku edhe 30 milionë, përafërsisht 100 milionë, që të mbulohen nevojat e SHSKUK-së, që të ofrohen shërbimet për pacientët, të cilët marrin shërbime prej saj. Pra, është buxhet i pamjaftueshëm për SHSKUK, duke ditur se nën ombrellën vet ka të gjitha spitalet. Duke u nisur edhe nga vizita që kemi realizuar nëpër institucionet apo spitalet, pra secili drejtor i këtyre institucioneve, nuk ka qenë i kënaqur, qoftë me ndarjen buxhetore, qoftë me menaxhimin apo centralizimin që është bërë për mallra, shërbime dhe barna nga Ministria e Shëndetësisë. Ne, si Komision, pas kalimit të buxhetit në leximin e parë, t’i propozojmë disa amendamente dhe të shqyrtojmë mundësinë se a mund të ndikojmë në rritjen e buxhetit për shëndetësinë. Në buxhet nuk figurojnë fare mjetet për pagesën e mjekëve specialistë, të cilët tashmë janë duke punuar. Ne, si Komision, në këtë rast, do të ishte mirë që të propozojmë për sigurimin e mjeteve për këtë kategori, mandej edhe për specialistët. Po ashtu, te MPMS nuk është paraparë buxhet për kategorinë që më së shumti ka nevojë. Pra, nuk janë përfshirë në këtë buxhet paraplegjikët dhe tetraplegjikët, edhe pse ligji ka kaluar dhe parashihet që të fillojë pagesa në janar të vitit 2017. Faleminderit!

Hatim Baxhaku– Faleminderit kryetare! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne të gjithë e dimë se shëndetësia është një shërbim shumë i shtrenjtë, po thuajse për të gjitha vendet. Me sa kemi vërejtur edhe sivjet, ky buxhet nuk do t’i përmbushë nevojat e pacientëve. Sipas këtij projekt-buxheti, ka një rritje minimale në sektorin e shëndetësisë, pra nuk premtim një përmirësim të kënaqshëm të shërbimeve shëndetësore. Mirëpo, me ndarjen e 18 milionë eurove, që parashihen për fondin e sigurimeve shëndetësore, si dhe fillimi i mbledhjes së premiumeve, besojmë shumë se do të kenë efektin e vet, në raport me ofrimin e shërbimeve, si dhe furnizimin me barna. Edhe unë nuk jam i kënaqur me këtë buxhet, pasi që punojmë në spital dhe çdo ditë i shohim mungesat e barnave dhe pajisjeve. Edhe përkundër që është thënë se mbi 70% ka qenë e mbuluar lista e barnave esenciale, mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme dhe nuk kemi ende një të dhënë të saktë, lidhur me këtë furnizim dhe sa ka mungesa buxhetore për të përmbushur këtë obligim. Do të ndalem tek aftësimi specialistik dhe edukimi i vazhdueshëm. Kjo shumë, në vlerë prej 3 milionëve, është e pamjaftueshme dhe nuk i mbulon as specialistët, të cilët janë mbështetur edhe nga Kuvendi, ku kemi kërkuar që të futen në kategorinë e pagave të gjitha kategoritë A, B dhe C dhe këtu rekomandojmë që të rritet kjo shumë për 1 apo 1.5 milion për mbulimin e kësaj kostoje. Trajtimi jashtë vendit, përveç shumave të mëdha që shkojnë nga buxheti i shtetit, mund të themi më shumë se dhjetë fish shpenzohen edhe nga vetë qytetarët, si pasojë që mungojnë disa shërbime që nuk ofrohen nga institucionet publike. Në këtë rast, shteti ka për obligim që për pacientët që kanë nevojë për ofrimin e shërbimeve urgjente apo vitale, për pacientin t’i ofrojë apo të rrisë shumë diku 2 deri 3 milionë euro. Sipas të dhënave nga MSH, ky fond ka mungesë të mjeteve, dhe për vitin 2016, ka 3 milionë obligime të papaguara. Kurse, punësimi i mjekëve specialistë të papunë, këtu është marrë një vendim politik, mirëpo unë konsideroj se këtu nuk është analizuar mirë, ku shumica prej tyre kanë qenë të punësuar dhe kanë pasur edhe nga dy vende punë dhe jo domosdoshmërisht ka obligim shteti që t’ju sigurojë vend pune në institucionet publike. Sidoqoftë, vendimi është marrë dhe duhet të bëhet një zgjidhje për specialistët e papunë. Në bazë të këtij projektbuxheti, SHSKUK ka të

planifikuar 6720 punëtorë, kurse të punësuar i ka diku 6601 punëtorë. Pra, këtu mund të angazhohen edhe 120 mjekë specialistë, dhe në këtë rast, t'i shpërndajë nëpër spitalet ku ka mungesë të stafit, si në Mitrovicë, Vushtrri dhe në të gjitha spitalet tjera ku kanë mungesë të kuadrove. Faleminderit !

Kryetarja– Në bazë të informatave që na janë ofruar, lidhur me specialistët, kanë qenë të punësuar nëpër institucionet private, janë tërhequr dhe janë punësuar fillimisht për tre muaj, në bazë të vendimit të Kuvendit në institucionet publike, kryesisht në QKUK. Dhe nuk është bërë shpërndarja, si duhet, nëpër institucionet ku ka mungesë të kuadrove sipas specializimit që kanë. Pra, janë punësuar pothuajse të gjithë në QKUK dhe kjo vërteton se nuk kemi planifikim të mirë të nevojave të kuadrove.

Ali Berisha– Kolegët potencuan se kemi një rritje minimale të buxhetit për shëndetësi, mirëpo nëse e analizojmë në total, 6.7 % e buxhetit është ndarë për MSH-në, që është niveli më i ulët në rajon. Kjo e determinon atë që shëndetësia nuk është fare prioritet dhe kjo qasje duhet të ndërrojë sa më parë.

Kryetarja– Mësa kam vërejtur, nuk ka një buxhet për mirëmbajtjen e pajisjeve apo aparaturave dhe shpeshherë kemi mosfunksionimin e këtyre pajisjeve, pasi që na mungojnë ekspertët për rregullimin e këtyre aparaturave. Ky shërbim patjetër duhet të planifikohet me buxhet, pasi që kushton si me vonesë, po ashtu, me dërgimin e pacientëve për shërim jashtë vendit. Është e vërtet se ka shumë nevoja për buxhet, si në sektorin e shëndetësisë, po ashtu edhe në sektorin e mirëqenies sociale. Vlen të theksohet se Ligji për shërbimin mjekësor emergjent, në të cilin kemi punuar shumë si Komision dhe besoj se diçka duhet të fillojë edhe me mbështetjen buxhetore për fillimin e zbatimit të këtij ligji. Në rast se keni propozim-amendamente konkrete apo mendoni si Komision duhet të bëjmë propozim-amendamente, atëherë pas leximit të parë, ne si Komision, do të shohim dhe do ta procedojmë ndonjë propozim-amendament.

Ali Berisha– Ne, si Komision, mendoj se mund të pajtohemi së paku në dy çështje, të provojmë t'i shtyjmë. Të propozojmë që buxheti për tretman jashtë vendit të ketë një rritje, pasi që nevojat janë të mëdha dhe kemi deficit në atë fond në MSH. Po ashtu, një propozim i imi, që kërkoj edhe mbështetjen tuaj, si kolegë deputetë, një investim në spitalin e Gjakovës. Pasi që e kanë përgatitur projektin detal, që të paktën të ndahet një shumë e buxhetit, në mënyrë që të fillohet me investime, pasi që nevojat janë shumë të mëdha.

Kryetarja– Atëherë, edhe pse disa prej jush diskutuat edhe për buxhetin e MPMS-së, mirëpo nëse ka dikush të shtoj diçka me tepër, urdhëroni.

Pra përveç Ligjit për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, a ka dikush vërejtje te buxheti i MPMS-së? Kemi edhe Ligjin për veteranët e UÇK-së, Ligjin për pensionet familjare dhe invalidor. Atëherë, nëse keni propozim-amendamente, ne si Komision, pas kalimit të projektbuxhetit në lexim të parë, do të shohim dhe të mbledhemi, si Komision.

4. Të ndryshme

Flora Brovina (kryetare) Te kjo pikë, ne si Komision, kemi pranuar një shkresë nga Oda Ekonomike Amerikane, e cila përmes kësaj shkrese kërkon që të mos fillohet me mbledhjen e premieeve, për shkak se MSH ende nuk i ka përfunduar të gjitha përgatitjet e nevojshme për të filluar me mbledhjen tyre. Ne, si Komision, në takimet që kemi realizuar me ministrin e MSH-së dhe stafin e tij, iu kemi kërkuar që të kenë kujdes në fillimin e mbledhjes së premieeve, para se të

kryhen të gjitha përgatitjet e nevojshme. MSH-ja na ka njoftuar me përgatitjet që i kanë bërë për fillimin e tyre dhe konsiderojnë se i kanë bërë përgatitjet e nevojshme për të filluar në janar 2017. Kurse, sa i përket fillimit apo pezullimit edhe për një kohë, kjo çështje është përgjegjësi e MSH-së apo Qeverisë.

Po ashtu, kemi një kërkesë nga një grup profesorësh dhe studiuesish të Institutit Albanologjik, të cilët janë mbi moshën 65 vjeçare. Pse nuk po paguhen pensionet kontributdhënëse për gradat shkencore magjistër dhe doktor i shkencave? Si dhe a planifikohet, në të ardhmen, të njihet kjo e drejtë? Ne, me sa jemi në dijeni, një kategorizim është bërë i pensionisteve kontributdhënëse nga ana e MPMS-së dhe me sa jemi në dijeni kategorizimi është bërë deri në shkollimin me fakultet, në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm.

A ka dikush të shtojë diçka te kjo pikë? Jo. Atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje në mbledhje dhe për kontributin tuaj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA